



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT
14-148/02-64669/23, më 27. 03. 2023

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 5, paragrafi 5.2 të Ligjit për ndërmarrjet publike 03/L - 087 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 31/15, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë

V E N D I M

1. Z. Arton Shabani, LIROHET nga detyra e anëtarit në Komisionin Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale të Komunës së Prishtinës "Stacioni i Autobusëve" SH.A.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

Arsyetim

Z. Arton Shabani i emëruar me vendimin nr. 14.020/04 - 85677/22 të datës 19.04.2022, LIROHET nga detyra e anëtarit në Komisionin Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale të Komunës së Prishtinës "Stacioni i Autobusëve" SH.A.

Lirimi i tij nga detyra e aksionarit bëhet për shkak të angazhimeve të tij në NPL "Termokos", përkatësisht përgjegjësi që i njëjti i ka në bazë të kontratës për themelimin e marrëdhënies së punës në pozitën e zyrtarit financiar të ndërmarrjes Termokos. Gjithashtu, për shkak të këtyre obligimeve në NPL TERMOKOS, është e pamundur përkushtimi i tij në detyrën e aksionarit të NPL "Stacioni i Autobusëve", veçanërisht në këtë kohë kur kjo ndërmarrje kërkon një përkushtim të jashtëzakonshëm për t'i tejkalluar sfidat që ndërmarrja i ka në këtë periudhë.

I DORËZOHET:

- Z. Arton Shabani;
- NPL - Stacionit të Autobusëve
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

